



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Bazat e Antropologjisë**

Ngarkesa: 4 kredite

Viti / Semestri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Franceze 'Gjuhë dhe Komunikim '

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivi pedagogjik i këtij kursi është t'u ofrojë studentëve konceptet kryesore, t'i orientojë ata drejt historisë së mendimit antropologjik, t'i nxisë të kuptojnë, analizojnë dhe interpretojnë dukuritë kulturore dhe shoqërore si larmia kulturore, relativizmi kulturor, etj, të bëjnë dallimin me disiplinat e tjera fqinje të antropologjisë si shkencë e njeriut, duke punuar dhe u ushtruar mjaft mbi teknikat e investigimit, të analizës, të interpretimit, të sintezës dhe të arritshmërisë së objektivitetit në kërkimin e *kuptimit* dhe të *nëndërgjegjjes*, elemente kyç në kuptimin e shoqërive.

Bazat e Antropologjisë do të prekë veçse akset kryesore të disiplinës. Propozojmë të theksojmë: objektin e studimit, proceset e metodës dhe të reflektimit në kuptimin e aspekteve sociokulturore, të piketojmë terrenet e kërkimit, copëzat kulturore dhe debatet teorike që do të mundësojnë zgjedhjet dhe specializimet e mëvonshme të studentëve.

Pas një analize të koncepteve, të objektit të metodave, do të shpalosim një historik të shpejtë të rrymave kryesore teorike të antropologjisë që do të shpjegojë sesi njeriu tanimë është bërë objekt shkencor, që nga shekulli i XIX-të. Pas një hyrjeje të disiplinës do të diskutojmë rrymat e mëdha të mendimit që kanë shënuar historinë e antropologjisë (Evolucionizmin, difuzionizmin, kulturalizmin, funksionalizmin dhe strukturalizmin) me themeluesit e tyre, autorët bashkëkohorë dhe ata që sollën risi në këtë fushë.

Në mënyrë kronologjike do të analizojmë katër shtyllat e çdo sistemi shoqëror : farefisnia, ekonomia, politika, feja. Kapitulli i fundit do t'i kushtohet antropologjisë dhe lidhjes së saj me disiplinat si psh : letërsia dhe gjuhësia, apo prirjet e reja të antropologjisë.

Përveç zbulimit të rrymave të mëdha të mendimit etnologjik do të fokusohemi dhe te hyrja në metodologjinë e terrenit dhe te procesi i hetimit etnologjik, i quajtur *Vëzhgimi pjesëmarrës*, që nënkupton integrimin /përfshirjen e antropologut/studentit në komunitetin shoqëror që studion, Studentët do të përvetësojnë teknikat metodologjike gjatë anketimit, i cili do të finalizohet në fund të semestrit me një raport, që do të flasë për gjithë punën e bërë në terren nga studentët.